

Fjolla Kaprolli Ismaili PhD¹

UDC: 728.5.033.3(497.711)(091)

PROCEDURA E MEDIACIONIT NË SHBA

ПОСТАПКА НА МЕДИЈАЦИЈА ВО САД

MEDIATION PROCEDURE IN USA

Abstract

Mediation as an alternative way of resolving disputes is accepted and implemented in many different countries of the world and in Republic of North Macedonia as well. If we make a comparison in terms of the historical development of peaceful dispute resolution and alternative dispute resolution methods in the sense in which it is used today, the historical development of the latter is considered much shorter than the historical development of peaceful dispute resolution, which way of resolving disputes has been presented since the first stages of social communities. There is an opinion among historians that there have been instances where mediation has been used in disputes which have arisen in trade with the ancient Phoenicians and the ancient Babylonians. Mediation in ancient Greece was most often used in marital and family disputes. On the other hand, the ancient Romans used certain procedures similar to mediation, while the peaceful solution as a way of resolving the dispute in this period can be found in the book "Digesta" of the Justinian Code. In creating the basic concept of alternative dispute resolution, there is a resemblance to historical efforts to establish and define the concept of peaceful dispute resolution. When it comes to mediation or alternative dispute resolution methods, then we are dealing with a much different way of resolving the dispute compared to the litigation procedure but also arbitration, where the neutral third party

¹ Docent dr, Universiteti Ndërkombëtar Ballkanik, Shkup. Email: fjolla.kaprolli@ibu.edu.mk

helps the parties to reach until a common solution. As for the mediation procedure in the past and that which is applied today, is based in the techniques used in mediation which are systematized on American practices. In the United States of America, mediation is considered as an effective way to treat and solve the disputes, because parties participate with their good will and with faith that they will solve their dispute in this way. Today mediation in the American practice with its forms is considered as one of the most successful used method for resolving disputes of different nature which is the reason why its successful practice has been exemplified in the legal systems of different countries including the legal system of our country as well. In this paper the main focus will be placed in the legal development of mediation as a profession and institution in the United States of America.

Keywords: *ADR, Alternative dispute resolution methods, Mediation, Mediation in USA.*

Procedura e mediacionit në SHBA

1. Hyrje

Sot shohim një dinamikë të fuqishme të zhvillimit të raporteve shoqërore i cili zhvillim shoqëror vazhdimisht prodhon konteste të reja të cilat janë shumë të komplikuar dhe për fat të keq të shumta. Njerëzit çdo ditë në bashkësinë ku jetojnë dhe veprojnë, si në sferën private ashtu edhe në sferën e punës involvohen në situata kontestuese në të cilat situata ato përfshihen për shkak të rrethanave të ndryshme, ndërsa një pjesë e tyre shkaktohet përshkak të veprimet ose mosveprimet të tyre. Kontestet janë fakt në secilën shoqëri, reaksioni i të cilave manifestohet në ndonjërin prej modeleve apo mënyrave për zgjedhjen e kontesteve. Zgjedhja e kontesteve nga pikëpamja e të drejtës (këtu para së gjithash mendohet për procedurën gjyqësore) është metodë dominante në trajtimin e mosmarrëveshjeve respektivisht kontesteve dhe zgjidhjes së tyre. Pra, janë gjykatat ato të cilat trajtojnë dhe zgjidhin kontestet dhe mosmarrëveshjet ndërmjet palëve. Ky qëndrim është i pranishëm në disa qindra vitet e fundit. Mirëpo, si duket, këto vitet e fundit kur gjykatat janë bërë shumë të fuqishme së bashku me zhvillimin dhe modernizimin e shoqërive të shekullarizuara - SHTETEVE, këto të fundit ndajnë drejtësinë përmes gjykatave të tyre, duke u bazuar në ligje që duhet të jenë të barabartë për të gjithë. Zhvillimi i aparatit ligjor shtetëror i ka vënë nën

hije metodat tjera për zgjidhje të kontesteve deri në atë shkallë sa që procedura gjyqësore është bërë sinonim për metodën standarde, të rregullt dhe ndonjëherë edhe si metodë e vetme për zgjedhje të kontesteve juridike. Si pasojë e këtij lloji të perceptimit është bërë marginalizimi i mundësive tjera të cilat janë në dispozicion për zgjidhjen e kontesteve. Si efekt negativ i zhvillimit të tillë të mekanizmit gjyqësor është pamundësia e të njëjtit që të përballlet me nevojën e madhe për mbrojtje gjyqësore. Pra, cilado qoftë arsye, është e nevojës së madhe reflektimi i rolit të gjykatave mbi zgjidhjen e kontesteve dhe me këtë edhe gjetja e mënyrave tjera të zgjidhjeve të kontesteve. Shoqëritë bashkëkohore të cilët edhe pse demokracinë e vënë në pedestal, përsëri nuk mundet t'u ikin numrit të madh të kontesteve të cilët çdo ditë janë në rritje e sipër dhe me këtë edhe mbingarkesa e gjykatave. Për atë shkak të gjithë shtetet modern, e sidomos SHBA-të, u lëshuan në kërkimin e metodave të reja të zgjidhjeve të kontesteve të ashtuquajtura, mënyra alternative të zgjidhjeve të kontesteve. Afirmimi i këtyre mënyrave alternative është një tregues i qartë për problemet me të cilat ballafaqohet gjyqësori në këtë shtet.

Mediacioni është një ndër metodat më të shpeshta të cilat përdoren si metoda të zgjidhjeve alternative të kontesteve dhe e cila është vlerësuar si mënyrë më e shpejtë, efikase dhe më ekonomike e zgjidhjeve të kontesteve, si dhe si mënyrë më e mirë e shkarkimit të gjykatave. Si rezultat i këtyre vetive, mediacioni i ka të gjitha predispozitat për t'u bërë mënyra dominante e trajtimit dhe zgjedhjeve alternative të kontesteve. Mediacioni është mënyrë e zgjedhjes të konflikteve dhe tejkalimit të mosmarrëveshjeve përmes palës së tretë e cila është neutrale dhe e cila paraqitet në rolin e mediatorit, respektivisht të ndërmjetësuesit në mes të dy palëve të cilët kanë kontest në mes vete. Qëllimi i mediacionit është që konflikti të drejtohet në mënyrë konstruktive dhe të vijë deri në një zgjedhje të shpejtë dhe të përbashkët rreth së cilës ekziston pajtueshmëri nga të dyja palët.

2. Hapat e para të mediacionit në SHBA

Nga të gjitha vendet e botës, Shtetet e Bashkuara të Amerikës konsiderohen si vend i cili mban vendin e parë për nga numri më i madh i kontesteve në raport me numrin e banuesve në të.² Mbingarkesa e

² А. Марковић, Е. Крстић, Ј. Цветковић, М. Благојевић, М. Живковић, (2009), Медијација на територији града Ниша - ставови грађана и искуства професионалаца, Зборник радова Правног факултета у Нишу, број 53, Nish, f. 261

gjykatave në SHBA, ka rezultuar me procedura kontestimore të gjata dhe të lodhshme, si rezultat i të cilave janë derdhur një shumë e madhe e parave për mbulimin e shpenzimeve procedurale dhe në fund “feedback-u” (rezultati) final është pala e pakënaqur. Për atë shkak si hap i parë për të shkarkuar gjykatat ka qenë vendosja e metodave alternative të zgjidhjes së kontesteve në sistemin juridik. Gjatë viteve 1970 dhe 1980 shumë gjykata federale të SHBA-ve filluan që të zbatojnë metodat alternative të zgjidhjeve së kontesteve si mediacionin, arbitrazhin dhe vlerësimin neutral të hershëm ose siç njihet në gjuhën angleze “*early neutral evaluation*”. Përpjekja e parë për futjen e mediacionit në SHBA është ndërmarr në vitin 1983. Në këtë vit është ndryshuar Ligji federal për procedurë kontestimore³ respektivisht është ndryshuar neni nr. 16, ndryshim ky që ka mundësuar që palët të udhëzohen në procedura jash-tëgjyqësore të zgjidhjeve së kontesteve të tyre. Më pastaj, në vitin 1990 me miratimin e Ligjit për reforma në gjyqësi - *Civil Justice Reform Act*, i cili bëri vërtet ndryshime në këtë sferë, respektivisht urdhëronte të gjithë gjykatat federale dhe ato të rrethit që të formojnë njësi këshilluese që të mund të gjejnë mënyra për të shkurtuar procedurat e gjata gjyqësore, me çka këshillohen që gjykatat të përdorin metoda të ndryshme për zgjidhjen alternative të kontesteve. Në vitin 2001 është miratuar Uniform Mediation Act, dispozitat e të cilit ishin të përbashkëta për legjislacionet e shteteve të SHBA-ve. Nisja e aplikimit të metodave alternative për zgjidhje të kontesteve fillimet i ka nga viti 1985 e cila është filluar si një program eksperimental i sponsorizuar nga Oda e avokatëve.⁴ Në vitin 1987 miratohet në Teksas Ligji mbi zgjidhjen alternative të kontesteve - *Texas Alternative Dispute Resolution Act*.⁵ Ky ligj përmban dispozita me të cilët rregullohen procedurat e shumë metodave alternative të zgjidhjes të kontesteve, si arbitrazhi – *arbitration*, konferenca si zgjidhje e moderuar - *moderated settlement conference*, gjykimi përmbledhës i jurisë - *summary jury trial* dhe mini gjykimi - *mini trial* përfshirë këtu edhe mediacionin i cili nga të gjithë metodat, konsiderohet si metoda më e përdorur për zgjidhje të kontesteve.

³ United States Code Annotated Federal Rules of Civil Procedure for the United States District Courts, neni 16, al. 1, pika 5

⁴ American Bar Association, <https://www.americanbar.org/>

⁵ Me këtë ligj u është dhënë gjyqtarëve që palët t'i udhëzojnë që kontestin e tyre ta zgjidhin nëpërmjet të njëres nga disa metodave alternative të zgjidhjeve të kontesteve të cilët janë të parapara në ligj.

Në vitin 1988 mediacioni filloi të rregullohet edhe në Florida⁶ dhe Oklahoma. Në Oklahoma në vitin 1988 hyri në fuqi Rregullorja nr. 16.3533. Në Oklahoma gjatë zbatimit të procedurës kontestimore tentohet që në mënyrë paralele me zgjidhjen e kontestit, palët të arrijnë marrëveshje në seanca të veçanta, apo siç quhen në gjuhën angleze “*Settlement Conferences*”. Shumë shpejt mbas arritjes së futjes së mediacionit në legjislacionet e tyre, në vitin 1990 një tentim i tillë u bë edhe në New Jersey (Nju Xherisi). Ky tentim erdhi si rezultat i Ligjit për reformat të gjykatave juridiko-civile e vitit 1990.⁷ Në Minesota zgjidhja alternative e kontesteve rregullohet me Rregullën nr. 114 e miratuar në korrik të vitit 1994 të Rregullave të përgjithshme mbi procedurën kontestimore (General Rules of Civil Practice). Kjo rregull më së shumti zbatohet për zgjidhjen e kontesteve nga fusha juridiko-civile dhe juridiko-familjare. Në këtë rregullore është përfshirë gjithë sqarimi i procedurës para gjykatës i cili do t’i udhëzoj palët respektivisht avokatët e tyre që kontesti të zgjidhet me anë të ndonjëres prej metodave alternative të zgjidhjeve të kontesteve, përfshirë këtu edhe medijacionin si metodë e tillë. Pas kësaj avokatët janë ato të cilët këshillojnë palët respektivisht klientët e tyre për zgjidhjen alternative të kontestit të tyre me anë të mediacionit. Më pastaj avokatët të të dy palëve kundërshtarë do të diskutojnë njëri me tjetrin për zgjidhjen alternative të kontestit të palëve. Në këto raste gjykata nuk qëndron aspak pasive. Ajo mundet që t’i udhërojë palët që të përdorin arbitrazhin e detyrueshëm nga njëra anë ose mediacionin si procedurë jo detyruese si metodë alternative të zgjidhjes së kontesteve.

Në vitin 1998 u miratua Ligji për zgjidhje alternative të kontesteve⁸, i cili ligj për qëllim kishte që në nivel federal të sigurohet një besueshmëri më e madhe e programeve të shumta në lidhje me metodat

⁶ Në Florida ligji me të cilën rregullohet zgjidhja alternative e kontesteve hyri në fuqi në janar të vitit 1988. Hapat e para u hodhën në vitin 1978 kur edhe u emërua Komiteti i Gjykatës Supreme për zgjidhjen alternative të kontesteve. Në vitin 1985 si rezultat i përvojës së këtij Komiteti, u realizua një studim i cili rekomandoi zbatimin gjithëpërfshirës të mediacionit dhe arbitrazhit në gjykatat e Floridës e cila u pranua dhe si pasojë e të cilës u miratua “Chapter 44, Florida Statutes” në shtetin e Floridës.

⁷ Deri në vitin 1992 u emëruan 29 mediatorë ndërsa në vitin 1993 ky tentim u konsiderua si shumë i suksesshëm dhe kështu mediacioni filloi të zbatohet në shumë sfera. Si rezultat i kësaj në po atë viti u miratua Rregulli 49 - Rule 49 of the Local Rules që rregullon shumë çështje të cilët kanë të bëjnë me mediacionin dhe procedurën e saj si p.sh.: emërimi i mediatorëve, shpërblimi i mediatorit, çështjet të cilët janë të përshtatshme për zgjidhje me anë të mediacionit, procedura dhe fazat në të cilat kalon mediacionit, udhëzimet për mediacion të suksesshëm dhe standardet etike të mediatorëve.

⁸ Alternative Dispute Resolution Act, Pub. L. No. 105-315, § 2, 112. Stat. 2993 (1998)

e zgjidhjes alternative të kontesteve në përgjithësi dhe mediacionit në veçanti programe këto që veç më ishin të përshtatura nga gjykatat e shteteve amerikane. Përderisa në fillim gjykatat kanë pasur të drejtë dhe obligim që palët t'i udhëzojnë të përdorin mediacionin si metodë e zgjidhjeve të kontesteve të tyre, me hyrjen në fuqi të këtij ligji, gjykatat e shkallës së parë ligji i urdhëronte që të implementojnë programet në lidhje me zgjidhjet alternative të kontesteve, përfshirë këtu edhe mediacionin si dhe të promovojnë këto metoda respektivisht mediacionin si zgjidhje alternative të kontesteve. Qëllim tjetër i këtij ligji ishte edhe që mediacionit të fillojë të trajtohet si procedurë e detyrueshme. Edhe në vitin 2001 u bë një tentim i cili vlen të përmendet pasi që i njëjti doli i suksesshëm - propozimi i një ligji të vetëm për mediacionin – *Uniform Mediation Act*.⁹ Rregullat të cilët përbëjnë këtë ligj të përbashkët për të gjitha shtetet e SHBA-ve u përpiluan si rezultat i praktikave të procedurës së mediacionit në shtetet e SHBA-ve.

Në SHBA, modelet e shumta të mediacionit i autorizojnë gjykatat që ato vetë me bindjen e tyre të vlerësojnë çdo rast konkret dhe në bazë të atij vlerësimi të vendosin se një çështje kontestuese është apo jo e përshtatshme për t'u zgjidhur me anë të mediacionit. Gjithashtu gjykatave u është lënë që vetë të caktojnë rregullat sipas të cilave do të zbatohet procedura e mediacionit, gjë e cila shkakton laramani në atë se si vendosin gjykatat në lidhje me lëndët të cilët mund të zgjidhen me anë të mediacionit, si p.sh. mund të paraqiten rastet kur disa gjykata lejojnë që palët dhe gjithashtu i udhëzojnë të njëjtit që të inicojnë procedurë të mediacionit në të gjitha llojet e lëndëve juididiko-civile, ose disa nga ana tjetër mund të ndalojnë mediacionin në një numër të caktuar të lëndëve. Por pavarësisht kësaj, në SHBA është e pamohueshme fakti se edhe pse gjykatat mundet që palët t'i udhëzojnë në tentimin e zgjidhjes së kontestit të tyre me anë të mediacionit, prapëseprapë vendimin kryesor e kanë palët nga të cilët varet çështja e inicimit të mediacionit, ndërsa gjykata nga ana tjetër nuk është asgjë më shumë se sa një faktor i cili i ndihmon palës që të zgjedh në mes dy mundësive, mediacionit

⁹ Uniform Mediation Act, National Conference of Commissioners on Uniform State Laws, nr. 312/915-0195, Chicago Illionis. Në këtë ligj fillimisht përcaktohen nocionet themelore të mediacionit, si palët e mediacionit, mediatori, procedura e mediacionit, e kështu me radhë. Pastaj në pjesët tjera përcaktohet fushëveprimi i mediacionit, e drejta e refuzimit të pranimit, pranueshmëria dhe zbulimi; heqja dorë nga e drejta e pranimit; përjashtime nga e drejta e pranimit nga ana e palëve; konfidencialiteti; pjesëmarrja në procedurën e mediacionit; zbatimi i përbashkët; klauzola e pjesshme; mjetet juridike të goditjes dhe aplikimi i marrëveshjeve ekzistuese.

ose procedurës kontestimore. Gjykata mundet që palët gjatë të gjithë procedurës kontestimore ta udhëzoj që çështjen e tyre kontestuese ta zgjidhin me anë të mediacionit. Sidomos neni 16 kërkon nga gjykata që vëmendje të veçantë t'i kushtohet seancës përgatitore sidomos për të vërejtur se a ekziston mundësia dhe mbi gjitha a mbizotëron atmosfera ndërmjet palëve për zgjidhje të kontestit të tyre nëpërmjet të mediacionit. Këtë bindje gjyqtari e fiton pasi që konsultohet me palët para se të njëjtëve t'ua propozoj mediacionin.

3. Fillimi, zbatimi dhe përfundimi i procedurës së mediacionit

Procedura e mediacionit fillon atëherë kur palët i paraqesin mediatorit parashtrësit të cilët janë të karakterit konfidencial në të cilët është e përcaktuar pozicioni i tyre në kontestin e caktuar. Hap i ardhshëm i mediatorit menjëherë pas kësaj është caktim i një seance e cila ka për qëllim takimin e palëve dhe uljen e tyre në bisedime me qëllim që të arrihet marrëveshja ndërmjet tyre. Varësisht nga natyra e kontestit, disa arrihen që të zgjidhen qysh në seancën e parë të mediacionit, ndërsa te ato të natyrës më të komplikuar ndonjëherë duhet më shumë kohë dhe më shumë seanca për t'u zgjidhur kontesti në tërësi. Në procedurën e mediacionit në SHBA, lejohet përzjerja e gjykatës gjatë procedurës atëherë kur pala merr pjesë në procedurë të mediacionit me qëllime të këqija (edhe pse këto raste janë shumë të rralla pasi që palët janë ato të cilët me vetëdëshirë dëshirojnë që të zgjidhin kontestin me marrëveshje për mediacion) dhe në të cilët raste të njëjtit munden të sanksionohen.¹⁰ Në SHBA, çështja e asaj se kush mund të emërohet si mediator rregullohet më ndryshe se tek ne. Mediatorët duhet të marrin pjesë në programe të ndryshme, si dhe trajnime të cilët caktohen nga gjykatat para se të emërohen si mediator në listën e mediatorëve. Sa u përket kushteve të përgjithshme të cilët duhet t'i përmbushin mediatorët e caktuar nga gjykata, dallojnë nga shteti në shtet, pasi që secili mban të drejtën ekskluzive që të përcaktoj rregulla me të cilat rregullohen çështje të tilla. Si kusht bazë konsiderohet trajnimi i mediatorëve. Gjykatat si zakonisht kërkojnë që mediatorët të kenë kaluar minimum 20 orë deri në 40 orë trajnim të aprovuar për mediacion.¹¹ Përse trajnimeve në SHBA u

¹⁰ Sanksioni në rastet të tilla më së tepërmi ka të bëjë me mbulimin e të gjithë shpenzimeve procedural të procedurës së mediacionit.

¹¹ <https://legalstudiesms.com/learning/court-certified-mediator-qualification-requirements/#FL>

kushtohet rëndësi e madhe? Kjo pasi që ajo përfshin të gjitha aspektet e procedurës, nga fillimi deri në fund, siç janë: krijimi i rregullave themelore, tejkalimi i situatave problematike, se si të përfundojë bisedat ndërmjet palëve dhe të mbajturit mend të zgjidhjes përfundimtare. Gjatë trajnimeve të mediatorëve të rinj gjithmonë mbrapa u rrinë mediatorët me përvojë nga të cilët mediatorët e rinj përfitojnë nga përvoja e pasur e tyre, ashtu që gjithmonë gjatë punësive të cilët organizohen nëpër trajnime, mediatorët e rinj marrin shembuj konkret për zgjidhje dhe të njëjtën e zgjidh në prani dhe sipas instruksioneve të mediatorit me përvojë. Në SHBA kërkohet me të madhe që trajnimet të bëhen në mënyrë të pandërprerë me qëllim që mediatorët t'i përvetësojnë vazhdimisht njohuritë dhe aftësitë e tyre.

Me përfundimin e bisedimeve përfundon edhe procedura e mediacionit ndërmjet palëve e cila rezulton me lidhjen e marrëveshjes ndërmjet palëve. Mirëpo jo gjithmonë kjo është rezultat i procedurës së mediacionit. Edhe pse në teorinë juridike mediacioni në përgjithësi është një procedurë vullnetare, në praktikë nuk konsiderohet ashtu, si për nga dispozitat juridike të cilët e rregullojnë këtë procedurë si të obligueshme, ashtu edhe për nga udhëzimi i detyrueshëm nga ana e gjyqtarit që gjithsesi të mundohen që kontestin e tyre ta zgjidhin me anë të mediacionit. Edhe përkundër insistimit të tij, në asnjë mënyrë nuk do të thotë se palët janë të lidhura për urdhrin respektivisht udhëzimin e gjykatës për ta zgjidhur kontestin me anë të mediacionit. Ato kanë të drejtë që në çdo fazë të procedurës të heqin dorë nga ajo dhe të njëjtën të mundohen ta zgjidhin në procedurë kontestimore para gjykatës kompetente. Kur procedura e mediacionit përfundon në mënyrë të suksesshme, pra me marrëveshje të mediacionit ndërmjet palëve, për dallim nga Republika e Maqedonisë së Veriut, marrëveshja nuk inkorporohet në procesverbal për lidhje të pajtimit gjyqësor. Sot në gjykatat federale të SHBA-ve nuk ekzistojnë mekanizma speciale për ta bërë një marrëveshje të arritur me anë të mediacionit të përmbarueshëm.¹² Kjo është kështu pasi që në kulturën për nga aspekti juridik në këtë vend, marrëveshja e arritur përmbushet nga palët në mënyrë vullnetare dhe pa pasur nevojë të ekzistoj ndonjë dispozitë e cila do të urdhëroj përmbushjen e detyrueshme të saj me ç'rast edhe nevoja për t'u konsideruar kjo marrëveshje si dokument përmbarues si konsiderohet tek ne është e panevojshme bile - bile edhe e pakuptimtë.

¹² F. Ali. Sh, (2018), Court Mediation Reform: Efficiency, Confidence and Perceptions of Justice, Edward Elgar Publishing, Cheltenham UK, pika 8.3.6

Ajo që e bën specifike procedurën e mediacionit është se mediatori gjatë seancës së parë në të cilën takohen palët dhe avokatët e tyre, përveç se sqaron natyrën e procedurës së mediacionit e cila e bën të dallojë atë nga procedura kontestimore, rolin e mediatorit dhe të drejtat dhe obligimet e palëve, ai gjithashtu u sqaron edhe çështjen e shpenzimeve palëve.¹³ Nëse tek ne shpenzimet procedurale të cilët shkaktohen si rezultat i zbatimit të mediacionit mbulojnë nga të dyja palët në mënyrë të barabartë, në SHBA shpenzimet procedurale dhe ajo se kush do t'i mbulojë ato, zgjidhet në mënyrë të ndryshme por prapëseprapë ato janë në barrë të vetë palëve. Shpenzimet e mediacionit përbajnë: shpenzimet të cilët janë bërë si rezultat i organizimit të mediacionit, shpenzimet dhe shpërblimet e mediatorit i cili është zgjedhur për të zbatuar mediacionin dhe shpenzimet direkte të palëve.¹⁴ Mënyra se si vendoset për shpenzimet procedurale të mediacionit në SHBA dallon nga shteti në shtet.¹⁵ Gjithashtu gjykata ka të drejtë që të intervenojë në lartësinë e shpenzimeve nëse konsideron se mediatori ka caktuar një çmim jo të arsyeshëm për shërbimet e mediacionit.

Conclusion

Nowadays the existence of mediation as a method of resolving disputes can not be denied. Even that today the conditions are more favorable for the better functioning of the judiciary, where the number of judges and lawyers is increasing from day to day, the problem of overload is an issue which in no way can be avoided because the

¹³ Ibid, pika 8.3.3

¹⁴ <https://settlethedispute.com/cost-of-mediation-lawsuit>

¹⁵ Për shembull në New York nëse bëhet dallimi i shpenzimeve të cilët duhet të mbulohen nga palët për shkurorëzim në procedurë kontestimore dhe atë të mediacionit do të vërejmë një dallim të madh të shumës e cila kuptohet se ajo e cila shkakton shpenzimet më të mëdha është procedura kontestimore. Sipas web faqes www.settlethedispute.com shpenzimet mesatare të një shkurorëzimi në procedurë kontestimore mundet të jenë rreth 50.000 dollarë ndërsa në procedurë të mediacionit kjo shumë mundet të jetë në mes 5.000 dhe 8.000 dollarë. Në Majami të Floridës shpenzimet caktohen në bazë të të ardhurave të palëve, kështu p.sh nëse pala ka të ardhura prej 100.000 dollarë atëherë shpenzimet për seancë për palën të cilët duhet t'i mbulojë janë 120 dollar, ndërsa nëse ka të ardhura më pak se 50.000 dollar atëherë 60 dollarë do t'i kushtojnë shpenzimet palës për një seancë të mediacionit. Në Detroit Michigan, shpenzimet përcaktohen në orë. Çmimi i orës së mediatorit varion nga 150 deri në 350 dollarë varësisht prej asaj sa e komplikuar është çështja kontestuese, rezultati i cili arrihet si dhe faktorët tjerë.

number of disputes between citizens is too large and there is no attempt to reduce it. The fact that the parties largely choose the court procedure to resolve their disputes is not justified at all. Long litigation procedures that ends with unsatisfactory results for the parties and at great expense does not justify the settlement through the classical court procedure, but on the other hand justifies the introduction of alternative dispute resolution methods including mediation as such. In this last period, the term alternative dispute resolution in itself contains the idea of methods interacting with the contentious procedure, because it is undeniable the right of citizens to be able to seek legal protection in the courts where they live and operate. For this reason, even on the stage, ADR methods or alternative dispute resolution methods are presented and promoted which operate outside the judiciary even though they may be related to it (eg mediation ordered or instructed by the court).

Citizens need to understand once and for all that resolving their disputes in court is their last option available, especially when their dispute can be resolved in other ways as well. They should also understand that this does not mean that these methods replace the judiciary, i.e. the court procedure. It will continue to be the regular and primary procedure as well as the dominant one in resolving disputes. But this only means an opportunity for disputes to be resolved faster, easier and cheaper. Thus, to a large extent, the same goal is achieved as in the contentious procedure, but with some better qualities, such as faster and more qualitative given legal protection, as well as the establishment of the judiciary and the non-disruption of the relations between the parties, but on the contrary their rearrangement.

Due to the successful results as well as the great support, both from the parties, their lawyers and the court as well, the resolution of disputes through mediation is considered as a very appropriate way of resolving disputes, but also for the settlement of some problems that exist in the judicial system. This means that in the future the greater use of alternative dispute resolution methods will continue, including mediation as the alternative method which is the most widely used of all extrajudicial methods in the USA, and on the other hand also implies the weaker use of contentious procedure as a regular court procedure.

During the analysis of literature and laws of USA, there was an increase and sophistication of the mediation method, as well as training of mediators who have in fact been the key to improving the situation, respectively reducing the number of unresolved cases by the courts in

these states. If we look with a critical eye at what has been done and achieved in the USA, despite the fact that the way of development of the mediation procedure both in this country and the development and practice in Republic of North Macedonia, the use of mediation as an alternative method of dispute resolution remains far behind, compared to countries that have developed this method on a large scale and for a long period of time. Mediation in the Republic of North has been officially recognized in the legal system since 2006, which was the year of reform for the judiciary of our country, because the first law on mediation was issued as an alternative court procedure, while amendments and supplements and finally the issuance of a new law in 2013 paved the way for the further development of the mediation procedure. Given that mediation presents a relatively new idea, in theory and in practice the purpose, its elements and expectations are not very elaborated. But the idea of resolving disputes through mediation as an alternative method of resolving disputes without the participation of the element of justice, in fact does not present a bad idea. Although it is thought that this way will greatly affect the solution of the problem with the overload of the judiciary in our country, mediation is considered of good potential to start in this direction, but most of the work remains with the judicial system itself, who should pursue mediation in terms of the effectiveness of dispute resolution, and why not in terms of its economy. In a relatively large number of cases, alternative dispute resolution methods, including mediation as such, can lead to a more creative, faster and cheaper dispute resolution as well, compared to resolution which can be reached in court. The state must also make sure that alternative methods of resolving disputes, including mediation, succeed and at least give their result in the field of unloading of courts in the Republic of North Macedonia, which is a long-standing problem of that is not being resolved even today. Thus, the state is the one who, based on its obligation to organize a dispute resolution system, must finance and regulate the implementation of alternative dispute resolution methods in the same way as it regulates the implementation of the dispute resolution system of the regular court proceedings.

Recensentë:
Prof. dr. Adnan Jashari
Doc. dr. Xhemile Saliu

Bibliografia

- Alternative Dispute Resolution Act, Pub. L. No. 105-315, § 2, 112. Stat. 2993 (1998)
- B. Goldberg, Stephen, E.A. Sander, Frank, H. Rogers, Nancy, (1999), *Mediation and other processes*, third edition, Aspine Law and Business, Gathersburg and New York
- Betancourt. J, A. Crook. J, *ADR, Arbitration and Mediation*, AuthorHouse, Bloomington USA
- Bollen. K, Euwema. M, Munduate. L, (2016), *Advancing Workplace Mediation through Integration of Theory and Practice*, Springer International Publishing, Switzerland
- Boulle, L, *A history of alternative dispute resolution*, ADR Bulletin, Vol.1, nr.7, Article.3Clark. B, (2012), *Lawyers and Mediation*, Springer, London
- F. Ali. Sh, (2018), *Court Mediation Reform: Efficiency, Confidence and Perceptions of Justice*, Edward Elgar Publishing, Cheltenham UK
- F. Ali. Sh, (2018), *Court Mediation Reform: Efficiency, Confidence and Perceptions of Justice*, Edward Elgar Publishing, Cheltenham UK
- F. Butler, Valerie, (2004), *Mediation essentials and expectations*, Domance Publishing Co Inc, Pittsburg, Pennsylvania
- Folberg. Jay, L.Millne Ann, Peter Salem, (2004), *Divorce and family mediation, Models, techniques and applications*, The Guilford Press, New York
- Goldberg. B S, Brett. M J, Blohorn-Brenneur. B, Rogers.H N, *How mediation works: Theory, Research and Practice*, Emerald Group Publishing, UK
- <https://legalstudiesms.com/learning/court-certified-mediator-qualification-requirements/#FL>
- <https://settlethedispute.com/cost-of-mediation-lawsuit>
- <https://www.americanbar.org/>
- Hussey. D, (2009), *Conciliation: Coming out of the shadows?* Commercial Law Practitioner, 16(3), CLP48
- J. Brown, Henry, L. Mariot, Arthur, (1997), *ADR Principles and Practice*, Second edition, EdSweet and Maxwell
- Jerome T. Barnett, Joseph P. Barnett, (2004), *A history of alternative dispute resolution: the story of a political, cultural and social movement*, San Francisco CA

- Lovenheim. P, Guerin. L, (2004), *Mediate don't litigate, Strategies for Successful Mediation*, Berkeley
- Malone A. L, (2008), *International Law*, Aspen Publishers, New York
- Morasso, Greco, Sara, (2011), *Argumentation in Dispute Mediation, A reasonable way to handle conflict*, Amsterdam/Philadelphia
- R. Niemic, D. Stienstra, R. Ravitz, (2001), *Guide to Judicial Menagement of Cases in ADR*, Federal Judicial Centar, Washington
- Spencer. D, Brogan. (2006), *M, Mediation Law and Practice*, Cambridge University Press, Cambridge
- Uniform Mediation Act, National Conference of Commissioners on Uniform State Laws, nr. 312/915-0195, Chicago Illionis
- United States Code Annotated Federal Rules of Civil Procedure for the United States District Courts
- А. Марковић, Е. Крстић, Ј. Цветковић, М. Благојевић, М. Живковић, (2009), *Медијација на територији града Ниша - ставови грађана и искуства професионалаца*, Зборник радова Правног факултета у Нишу, nr 53, Nish